



# Republika e Kosovës

Komuna e Rahovecit



Kabineti i Kryetarit

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRIDSEDILA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Br./No. 2913 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 63  
Data/Datum/Date 1 / 11 / 22  
RAHOVEC / ORAHOVAC

## LISTA E VENDIMEVE NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI: TETOR 2022

| Nr  | Emri i vendimit                                                                                             | Nr. Protokollit  |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| 1.  | Vendim për caktimin e komisionit për Regjistrimin e Pasurisë jo financiare                                  | NRP-02-2766-2022 |
| 2.  | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e pronës komunale për këmbim                                | NRP-02-2767-2022 |
| 3.  | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave                                                  | NRP-02-2768-2022 |
| 4.  | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave                                                  | NRP-02-2769-2022 |
| 5.  | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-2777-2022 |
| 6.  | Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për procesin e barrës administrative                              | NRP-02-2780-2022 |
| 7.  | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-2790-2022 |
| 8.  | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-2791-2022 |
| 9.  | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-2795-2022 |
| 10. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                | NRP-02-2797-2022 |
| 11. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                | NRP-02-2798-2022 |
| 12. | Vendim për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit të rregullt                                      | NRP-02-2800-2022 |
| 13. | Vendim për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit të rregullt                                      | NRP-02-2801-2022 |
| 14. | Vendim për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit të rregullt                                      | NRP-02-2802-2022 |
| 15. | Vendim për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit të rregullt                                      | NRP-02-2803-2022 |
| 16. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                | NRP-02-2807-2022 |
| 17. | Vendim për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pacientëve                    | NRP-02-2808-2022 |
| 18. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave                                                  | NRP-02-2810-2022 |
| 19. | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-2811-2022 |
| 20. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave                                                  | NRP-02-2812-2022 |

|     |                                                                                                                                                                                                        |                  |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| 21. | Vendim për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e shpërndarjes dhe shfrytëzimit të lëndëve djegëse (dru dhe pelet) në Administratë, Arsimit dhe Shëndetësi                                            | NRP-02-2813-2022 |
| 22. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                           | NRP-02-2818-2022 |
| 23. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                           | NRP-02-2819-2022 |
| 24. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                           | NRP-02-2820-2022 |
| 25. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                           | NRP-02-2821-2022 |
| 26. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                           | NRP-02-2822-2022 |
| 27. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                           | NRP-02-2823-2022 |
| 28. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                           | NRP-02-2824-2022 |
| 29. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                           | NRP-02-2825-2022 |
| 30. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                           | NRP-02-2826-2022 |
| 31. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                           | NRP-02-2827-2022 |
| 32. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                           | NRP-02-2828-2022 |
| 33. | Vendim për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës                                                                                   | NRP-02-2829-2022 |
| 34. | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës                                                                                            | NRP-02-2831-2022 |
| 35. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                           | NRP-02-2832-2022 |
| 36. | Vendim për ndihmë financiare                                                                                                                                                                           | NRP-02-2833-2022 |
| 37. | Vendim për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2023-2027 në Komunën e Rahovecit                                                                       | NRP-02-2834-2022 |
| 38. | Vendim për pranimin në marrëdhënie pune                                                                                                                                                                | NRP-02-2838-2022 |
| 39. | Vendim për pranimin në marrëdhënie pune                                                                                                                                                                | NRP-02-2839-2022 |
| 40. | Vendim për pranimin në marrëdhënie pune                                                                                                                                                                | NRP-02-2840-2022 |
| 41. | Vendim për derivate                                                                                                                                                                                    | NRP-02-2841-2022 |
| 42. | Vendim për ndërprejen e kontratës me marrëveshje të dyanëshme me titull: "Ndërtimi i kompleksit memorial në fshatin Retijë"                                                                            | NRP-02-2843-2022 |
| 43. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e gjendjes së objektit të ish-Baltazar dhe objektit kolektiv të banimit                                                                                | NRP-02-2847-2022 |
| 44. | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës                                                                                            | NRP-02-2859-2022 |
| 45. | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës                                                                                            | NRP-02-2860-2022 |
| 46. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e automjetit                                                                                                                                           | NRP-02-2861-2022 |
| 47. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e pftartave                                                                                                                                            | NRP-02-2862-2022 |
| 48. | Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr.Prot. 02/359/21 i datës 20.4.2021 për caktimin e komisionit për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik | NRP-02-2866-2022 |
| 49. | Vendim për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen e shpërndarjes dhe shfrytëzimit të lëndëve djegëse (dru dhe pelet) në Administratë, Arsimit dhe Shëndetësi                                            | NRP-02-2867-2022 |
| 50. | Vendim për qasje në dokumente publike                                                                                                                                                                  | NRP-02-2871-2022 |
| 51. | Vendim për punë shtesë dhe punë të paparapara të Menaxherit të Projektit për projektin "Izolimi i objekteve të zjarriksave"                                                                            | NRP-02-2873-2022 |
| 52. | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës                                                                                            | NRP-02-2877-2022 |
| 53. | Vendim për caktimin e komisionit për ri-vlerësimin e ofertave                                                                                                                                          | NRP-02-2878-2022 |

|     |                                                                                                             |                  |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| 54. | Vendim për qasje në dokumente publike                                                                       | NRP-02-2884-2022 |
| 55. | Vendim për formimin e komisionit të rekrutimit për pranimin në punë të një specialisti të Ekonomisë         | NRP-02-2888-2022 |
| 56. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave                                                  | NRP-02-2891-2022 |
| 57. | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-2892-2022 |
| 58. | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-2893-2022 |
| 59. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave                                                  | NRP-02-2894-2022 |
| 60. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e inventarit                                                | NRP-02-2902-2022 |
| 61. | Vendim për dhënien e pushimit të lehonisë                                                                   | NRP-02-2905-2022 |







Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac / Municipality Orahovac

Kryetari i Komunës – Preshednik Opštine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2766 Nr. i faq./Br.str./No.pg 48

Data/Datum/Date 3.10.22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 2 dhe nenit 6 të Rregullores MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e komisionit për Regjistrimin e Pasurisë jo financiare dhe financiare**

1. **Caktohet komisioni për Regjistrimin e pasurisë jo financiare dhe financiare në Komunën e Rahovecit, në përbërje prej:**
  - 1.1 Asllan Mazreku, kryesues
  - 1.2 Admirim Durguti, anëtar
  - 1.3 Tefik Krasniqi, anëtar
  - 1.4 Samir Hasku, anëtar
  - 1.5 Sylejman Kadiri, anëtar
2. Komisioni për regjistrimin e pasurive jo financiare në Komunën e Rahovecit do të jetë organ i përkohshëm i formuar nga Kryetari i Komunës.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në Rregulloren MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më datë 31 dhjetor 2022.
5. Obligohet komisioni që me 31 dhjetor 2022 të paraqet raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Anëtarëve të komisionit, dhe
2. Arkivit.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Prešednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 24 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës i datës 07.03.2019, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e pronës komunale për këmbim**

1. **Caktohet komisioni për vlerësimin e pronës komunale për këmbim me pronën private, në përbërje prej:**
  - 1.1 Alban Gashi, kryesues
  - 1.2 Miftar Krasniqi, anëtar
  - 1.3 Ekrem Bytyqi, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e Pronës Komunale me Nr. 71510057-02186-0 në Zonën Kadastrale Rahovec, në posedim të P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC RRUGET e cila është rezultat i këmbimit me pronën private me Nr. P-71510057-02034-2 në Zonën Kadastrale Rahovec, se nuk ekzistojnë prona tjera komunës të përshtatshme për qëllimin e këmbimit.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punës të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
3. Arkivit.

|                                                                                        |                                                                                                                         |                                                                                     |
|----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
|     | REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO<br>KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC |  |
| KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET |                                                                                                                         |                                                                                     |
| Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)                                 |                                                                                                                         |                                                                                     |
| Nr./Br./No 2767 Nr. i faq./Br.str./No.pg 48                                            |                                                                                                                         |                                                                                     |
| Data/Datum/Date 3 / 10 / 22                                                            |                                                                                                                         |                                                                                     |
| RAHOVEC / ORAHOVAC                                                                     |                                                                                                                         |                                                                                     |





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – President of the Municipality / Mayor

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KASINET PRESIDENTIA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2768 Nr. ifaq/Br.sir/No.pg 48

Data/Datum/Date 3 / 10 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. Caktohet komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Furnizim me dru për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me Nr. prokurimi: 623-22-9763-1-1-1 dhe numër të brendshëm: 623-22-048-1-1-1 të datës: 3.10.2022, në këtë përbërje:
  - 1.1. Jeton Krasniqi, kryesues
  - 1.2. Liridon R. Gashi, anëtar
  - 1.3. Arta Kabashi, anëtare
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Furnizim me dru për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me Nr. prokurimi: 623-22-9763-1-1-1 dhe numër të brendshëm: 623-22-048-1-1-1 të datës: 3.10.2022.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Vendimi u dërgohet:**

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi  
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovo / Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – President of the Municipality

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësta Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2769 Nr. i faq./Br.str./No.pg 48

Data/Datum/Date 3.10.22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

#### Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërtimi i objektit të SHFMU “Hamëz Thaqi” në Xërxë”, me Nr. prokurimi: 623-22-7571-5-1-1 dhe numër të brendshëm: 623-22-031-5-1-1 të datës: 3.10.2022, në këtë përbërje:
  - 1.1. Jetmir Ukaj, kryesues
  - 1.2. Egzon Thaqi, anëtar
  - 1.3. Arta Kabashi, anëtare
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Ndërtimi i objektit të SHFMU “Hamëz Thaqi” në Xërxë”, me Nr. prokurimi: 623-22-7571-5-1-1 dhe numër të brendshëm: 623-22-031-5-1-1 të datës: 3.10.2022.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

#### Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi  
Kryetari i Komunës







Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Komuna e Rahovecit**  
Opština Orahovac / Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – President Opštine – **Municipal Mayor**



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO  
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC  
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSIEDNIA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2777 Nr. i faq/Br str/No.pg 49

Data/Datum/Date 4.10.22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

### V E N D I M

#### Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit" me numër të kontratës 623-22-8956-1-1-1, si në vijim:
  - 1.1 z. Admirim Durguti, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për paga dhe shpenzime pranë Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
  - 1.2 z. Avni Morina, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

#### Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Arsim, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi  
  
Kryetari i Komunës  
Zyrtar Kryesor Administrativ







**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
**Opština Orahovac / Municipality Rahovec**  
**Kryetari i Komunës – Presedni Opštine / Municipal Mayor**



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2780 Nr. i faq./Br.str./No.pg 49

Data/Datum/Date 4 / 10 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), në mbështetje të zbatimit të veprimit 3.2 të Planit të Veprimit 2022-2024 të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës nr. 27.29 të datës 14.09.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e zyrtarit përgjegjës për procesin e barrës administrative**

1. Zyrtar përgjegjës për procesin e barrës administrative në kuadër të Komunës së Rahovecit **caktohet** znj. Bjondina Ramaj, e sistemuar në punë dhe detyrat e Zyrtare e lartë për mbrojtje të mjedisit, pranë Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Rahovecit.
2. Përgjegjësitë e zyrtares përgjegjëse për procesin e barrës administrative, janë:
  - 2.1. Koordinimi i procesit të barrës administrative brenda Komunës së Rahovecit;
  - 2.2. Komunikimi, përfaqësimi dhe koordinimi me Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për mbarëvajtjen e procesit të barrës administrative, në kuadër të komunës;
  - 2.3. Pjesëmarrja dhe kontrollimi i politikave publike të zhvilluara nga Komuna, në kontekst të procesit të barrës administrative.
3. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Me vendim të njoftohen:**

- znj. Bjondina Ramaj,
- Zv. Sekretarja e MAPL-së,
- Zyra për Planifikim Strategjik / ZKM
- Arkivi.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac / Municipality Orahovac  
Kryetari i Komunës – President Opštine / Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET OF THE MUNICIPAL MAYOR

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2790 Nr. i faq./Br.str./No.pg 50

Data/Datum/Date 7/10/22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

### V E N D I M

#### Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Hartimin e projektit kryesor për projektin Parku Industrial në Oterushë" me numër të kontratës 623-22-9942-2-2-5/C422, si në vijim:
  - 1.1 z. Erhan Morina, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
  - 1.2 z. Afrim Limani, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

#### Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi  
Kryetari i Komunës  
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Komuna e Rahovecit**



Opština Oraovac / Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – **President of Municipality** / **Municipal Mayor**

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRIDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 2791 Nr. i faq./Br.str./No.pg. JO

Data/Datum/Date 7/10/22

RAHOVEC / ORAOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

### V E N D I M

**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Furnizimi dhe montimi i dyerve në shkollat" me numër të kontratës 623-22-8414-1-3-6/C418, si në vijim:
  - 1.1 z. Jetmir Ukaj, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar teknik i ndërtimtarisë pranë Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
  - 1.2 z. Avni Morina, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

*Me vendim të njoftohen:*

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Arsim, dhe
- Arkivi.

**Smajl Latifi**  
Kryetari i Komunës  
Zyrtar Kryesor Administrativ





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – President of Municipality – Mayor

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2795 Nr. i faq./Br.str./No.pg 51

Data/Datum/Date 10/10/22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Lot I – Izolimi i objekteve të zjarrfiksave" me numër të kontratës 623-21-4283-5-2-1/C316 si në vijim:
  - 1.1 znjsh. Diellza Çanta, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtare për efikasitet të energjisë, pranë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
  - 1.2 z. Përparim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/1641/22 i datës 03.03.2022.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Me vendim të njoftohen:**

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

Smaji Latifi  
Kryetari i Komunës  
Zyrtar Kryesor Administrativ





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit  
Opština Oraovac / Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2787 Nr. i faq./Br.str./No pg. 51

Data/Datum/Date 10/10/22

RAHOVEC/ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] Komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 4182, të dt. 3.10.2022 për ndihmë financiare prej 300.00€ (treqind euro) për mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### Arsyetim

[redacted] vuan nga sëmundja e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërbalueshme për të.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave për shërimin kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

### Me vendim të njoftohen:

- [redacted]
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

Smajl Katifi

Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit



Opština Orahevac / Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës – President of the Municipality / Mayor

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRIZEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 2798 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 51

Data/Datum/Date 11 / 10 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 22 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e z. Ermal Mullaabazi nga Rahoveci, me Nr. Protokolit 4138 të dt. 30.9.2022 për ndihmë financiare prej 1,000.00€ (njëmijë euro) për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të këngës kushtuar heronjve Xhelal Hajda-Toni dhe Selajdin Mullaabazi-Mici.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## A r s y e t i m

z. Ermal Mullaabazi ka marrë iniciativë për realizimin e projektit të këngës kushtuar heronjve Xhelal Hajda-Toni dhe Selajdin Mullaabazi-Mici, e cila do të titullohet “Bashkë në luftë – bashkë në përjetësi”. Kjo këngë do të jetë baladë heroike kushtuar luftëtarëve të orëve të para, tani heronj të Kosovës Xhelal Hajda-Toni dhe Selajdin Mullaabazi-Mici dhe ka për qëllim ti sjell publikut shqiptar një vepër artistike të nivelit të lartë kulturorë.

Andaj, duke marrë parasysh se Komuna e Rahovecit është e përkushtuar në rruajtjen dhe promovimin e vlerave kombëtare, është e domosdoshme ndihma financiare dhe përkrahja institucionale për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e këtij projekti.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

*Me vendim të njoftohen:*

- z. Ermal Mullaabazi nga Rahoveci,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.







Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Oraševac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – President of Municipality – Municipal Mayor

KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PREDSENIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2800 Nr. i faq/Br.str/No.pg 51

Data/Datum/Date 11 / 10 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr. 03/L-147 i datës 13.05.2010 dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në paga dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

**Për lejin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit të rregullt**

1. Me këtë vendim lejohe pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për z. Muharrem Krasniqi, i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës Zyrtar i gjendjes civile, pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit.
2. I njëjti ka të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës në shumën prej 30 (tridhjetë) euro për kurorëzimin e bërë jashtë objektit të komunës dhe jashtë orarit të punës me datë 23.09.2022.
3. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Arsyetim**

Me kërkesë të palës, z. Muharrem Krasniqi, i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës Zyrtar i gjendjes civile, pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit ka marrë pjesë në kurorëzimin e shtetasve të Republikës së Kosovës e që është bërë jashtë objektit të komunës dhe jashtë orarit të punës me datë 23.09.2022.

Për këtë arsye, duke marrë parasysh se zyrtari i lartpërmendur ka marrë pjesë në këtë kurorëzim jashtë objektit të komunës dhe jashtë orarit të punës, është e domosdoshme që të bëhet pagesa për punën shtesë jashtë orarit të punës, të paraparë me ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Me vendim të njoftohen:**

- Z. Muharrem Krasniqi,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Zyra e personelit, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Komuna e Rahovecit**  
Opština Orahovac / Municipality Rahovec  
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



|                    |                                      |
